

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Isa Kelmendi, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit B. A., nga ..., të cilin me autorizim e përfaqëson av. H. N., nga ..., kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Harudin Islami, për shkak të kompensimit të diferencës së pagës, duke vendosur sipas revizionit të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3380/2014 datë 22.5.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 18.9.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3380/2014 datë 22.5.2018,

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3380/2014 datë 22.5.2018,pjesërisht është pranuar ankesa e e të paditurës ashtu që është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë,C.nr.255/13 datë 15.7.2014, në pjesën me të cilën është aprovuar kërkesëpadia e paditësit dhe është obliguar e paditura që paditësit në emër të diferencës së pagave për vendin e punës të operatorit të përfshirjes, për periodën prej 01.03.2011 e deri më 01.06.2014 , t'ia paguajë në emër të ndryshimit për trustin pensional, t'ia paguaj shumën e e përgjithshme prej 3.805,42 € me kamatë prej 4,5 % në vit, duke filluar nga data e dhënies së ekspertizës me datën 01.06.2014 e deri në pagesën definitive e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë .Eshhtë

ndryshuar aktgjykimi i shkallës së parë sa i përket kamatës ashtu që është obliguar e paditura që të paguaj kamatën paditësit në lartësi që paguajnë bankat në mjetet e deponuar mbi një viti pa destinim të caktuar duke llogaritur nga dita e marrës së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë deri në pagesën definitive .Detyrohet e paditura që paditësit në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej 914,50 € , në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi me kërcënim të përmbarrimit të detyruar.

Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë, në afat ligjor revizion ka paraqitur e paditura, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e të dy gjykatave të ndryshohen dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditëses apo të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar.

Në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, del sene bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komonale në Pejë C.nr 629/09 të datës 10.11.2009 e paditura është obliguar që paditësit t'ia paguaj ndryshimin e pagës për vendin e punës Operator i Përfshirjes duke filluar nga data 01.11.2007 e deri me datën 28.02.2011,në shumën prej 3.031,20 €.Paditësi në procedurë të përmbarrimit ka realizuar shumën e aprovuar nga Gjykata Komonale në Pejë, mirëpo përkundër që paditësi ka vazhduar të kryej punët e Operatorit të Përfshirjes ,nga e paditura është paguar për vendin me gradën 5 e punës Teknik I .. Pavarësisht nga fakti se kryen këto punë të Operatorit të Përfshirjes, ndërsa është kompensuar për detyrat e punës që nuk i kryen. Grada për punët e zyrtarit ligjor është me gradën 10. Përkundër faktit se paditësja ka kryer punët e zyrtarit ligjor, ku është paraparë grada 6 e paditura ka paguar paditësen me gradën 5, edhe pse e paditura ka bërë kërkesë për pagesën e diferencës të ardhurave personale. Komisioni i ankesave të paditurës me vendimin e saj ..., të datës ..., ka aprovuar ankesën e paditësit ka urdhëruar që paditësit të kompensohet në mënyrë retroaktive diferenca ndërmjet gradës së teknikut I dhe Operatorit të Përfshirjes .Paditësja me kërkesën e parashtruar kërkon diferencën e pagës për periodën

01.03.2011 e gjerë më 01.06.2014 lartësinë e diferencës së pagave gjykata e vërtetoi në bazë të ekspertizës të ekspertit gjyqësor A. Sh., ekspert financiar.

Gjykata e shkallës së parë ka konkluduar se paditësi ka kryer punët dhe detyrat e punës të Operatorit të Përfshirjes për të cilin vend të punës ishte paraparë grada 6 siç janë kompensuar punëtorët tjerë. Është detyrimi i të paditurës t'ia paguajë paditësit diferencën e të ardhurave personale prej gradës 5 në gradën 6 për periodën prej 01.03.2011 e gjerë më 01.06.2014 në lartësinë të cilën e ka vërtetuar eksperti financiar.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën ankimore ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë përkitazi me sa i përket pagimit të diferencës së pagave prej gradës 5 në gradën 6, ndërsa ka ndryshuar për caktimin e lartësisë së kamatës e ndryshon duke gjykuar ashtu që obligohet e paditura që në shumën e gjykuar të paguajë kamatë që paguajnë bankat në mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, konsideron si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe arsyetimin e gjykatave të instancës më të ulët, sipas të cilit është aprovuar kërkesëpadia e paditëses, pasi që gjykata e shkallës së parë pa mëdyshje ka vërtetuar se paditësja pas datës 01.03.2011, sistemohet si Operatorit të Përfshirjes të e paditura, për të cilin vend të punës është grada 6 dhe se e paditura për periodën kontestuese ka paguar me gradën 5 .Paditësit i takon diferenca e pagave për këtë periodë.

Aktgjykimi i goditur është bazuar në zbatimin e drejtë të së drejtës materiale dhe atë të dispozitës së nënti 49 të Ligjit mbi bazat e së drejtës nga marrëdhënia e punës është përcaktuar se punëtorit i takon e drejta në të ardhura personale ku është e përcaktuar se i punësuari ka të drejtë në pagë e cila përcaktohet me kontratë të punës dhe se sipas punës së kryer. Paditësja për periodën prej 01.03.2011 e gjerë më 01.06.2014 është paguar me gradën 5 edhe pse ka kryer punët Operatorit të Përfshirjes ku është përcaktuar koeficienti 6.

Me dispozitën e nenit 372 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Fletorja zyrtare 29/78 RSFJ) e aplikueshme në kohën kur është krijuar raporti juridik është i përcaktuar se kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin në vit ose në afatet e caktuara më të shkurtra caktuar (kërkesat periodike) sikurse që është fjala për kërkesat periodike aksesore, sikundër është kërkesa e kamatës, ashtu edhe kur është fjala për kërkesat periodike të atilla në të cilat shuhet vetëm e drejta, sikundër që

është kërkesa e ushqimit, parashkruhen tre vjet nga rrjedhja e secilës dhënie të veçantë për pagesë.

Meqenëse paditësja kërkon diferencën e pagave për periodën prej prej 01.03.2011 e gjerë më 01.06.2014, paditësi padinë e ka paraqitur në afat ligjor , prandaj nuk qëndrojnë thëniet e revizionit se kemi të bëjmë me kërkesën e parashkruar në kuptim të nenit 83 pika 1 të Ligjit Themelor mbi Marrëdhëniet e Punës (Fletorja zyrtare e RSFJ 60/89), pasi që për pagesën e të ardhurave personale, paragrafi 2 të nenit 83, e përjashton llogaritjen e afatit nga paragrafi 1. Afatin e parashkrimit tre vjeçar për kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, përcakton neni 87 Ligji i Punës (Gazeta zyrtare 03/L 212).

Gjykata Supreme i ka vlerësuar si të pabazuar thëniet e të paditurës të cekura në revizion se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga nenin 182 al. 2 pika “n” të LPK-së nga se siç theksohet dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës se arsyetimi nuk përmban arsye lidhur me faktet përse gjykata ankimore ka gjetur se gabimisht është zbatuar e drejta materiale, sipas vlerësimit të gjykatës së revizionit aktgjykimi i goditur nuk është përfshirë me shkelje të tjera të procedurës, sepse dispozitivi i aktgjykimit të është i kuart dhe në harmoni me provat e administruara kur gjykata e shkallës së dytë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar në dispozitat ligjore.

Nga arsyet e cekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 222 të LPK.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.291/2018, më 18.09.2018

Kryetar i kolegjit,
Erdogan Haxhibeqiri